VENDIM
Nr.33, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV SCAN"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë", të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat "TV Scan", në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati